



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 787/6 prot

Datë 14.06.2021

V E N D I M
Nr. 281/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.06.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit Nr. REF-94482-05-04-2021 me objekt “Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”, me fond limit 4,166,572 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 25.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

Ankimues: Bashkia Patos
Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rr. “Unaza”, Patos.

Autoriteti kontraktor: Operatori ekonomik “Mag Utilities” SHPK
Adresa: “Rezidenca Kodra e Diellit 2”, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nënit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.05.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit me Nr. REF-94482-05-04-2021 me objekt “*Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore*”, me fond limit 4,166,572 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 25.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2. Në datën 11.05.2021 operatori ekonomik “Mag Utilities” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 787/2 prot., datë 17.05.2021, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Mag Utilities” SHPK.

II.5. Nëpërmjet shkresave nr. 1225/7 prot., datë 18.05.2021, protokolluar me tonën me nr. 787/3 prot., datë 20.05.2021 dhe nr. 1225/9 prot., datë 20.05.2021 protokolluar me tonën me nr. 787/4 prot., datë 24.05.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Mag Utilities” SHPK dhe me shkresën nr. 1225/6 prot., datë 18.05.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës (pikën 1 dhe pikën 2 të ankesës lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit, si dhe pikën 2 dhe pikën 8 të ankesës lidhur me specifikimet teknike). Konkretisht ankimuesi në pikat 1 dhe 2 të ankesës lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit ka ankimuar kërkesat e autoritetit kontraktor lidhur me përcaktimin e vinçit dhe kapacitetit mbajtës të kamionit duke kërkuar heqjen e tyre. Ndërsa, në pikat 2 dhe 8 të ankesës lidhur me specifikimet teknike, ankimuesi ka ankimuar përlllogaritjen e nivelit të efijencës së ndriçuesve, si dhe përcaktimin e peshës dhe dimensioneve të kablllove. Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton se pikat e mësipërme të ankesës janë pranuar si vijon:

“[...]Për sa i përket pikës 1 së pjesës së parë te ankesës Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit vëren se: Duke parë tipologjinë e procedurës së prokurimit e cila është kontratë malli, gjithashtu duke parë edhe zërat e preventivit një nga një vërejmë se mallrat objekt prokurimi janë mallrat, që mund të furnizohen pa qenë e domosdoshme pasja e një kamioni me vinxh nga ana e Operatorit Ekonomik.

Për sa më sipër kriteri i mësipërm do të modifikohet duke u hequr pjesa e vinxhit.

Për sa i përket pikës 2 së pjesës së parë te ankesës Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit vëren se: Bazuar në kohëzgjatjen e kontratës dhe në volumin total të mallrave që do të furnizohen përcaktimi i kapacitetit mbajtës të mjetit nuk është i domosdoshëm pasi këtë proces mund ta realizojë edhe një mjet me tonazh më të ulët ose më të lartë se ai i kërkuar në Dst. Më e përshtatshme do të jetë që Operatori ekonomik të disponojë në pronësi ose me qira një mjet transporti të përshtatshëm kamionçinë ose kamion duke u lënë hapësirë ofertuesve duke u dhënë mundësinë të shfrytëzojnë cilindo mjet që mund të kenë në dispozicion.

Ky kriter do të modifikohet duke hequr kapacitetin mbajtës.

Për sa i përket pikës 2 të pjesës së dytë të ankesës suaj lidhur me specifikimet teknike sqarojmë: Për sa i përket kursimit të energjisë në masën 80%, duam t'ju bëjmë me dijeni se niveli i kursimit të energjisë për jetëgjatësinë e aparaturës krahasuar me konsumin e llambave tradicionale me gaz është në nivele të tilla. Ne kemi sot në përdorim llamba me fuqi 250Ë dhe kërkojmë ti zëvendësojmë me llamba me fuqi 50-100Ë për të njëjtin fluks ndriçimi.

Për sa i përket këtij kriteri do të bëhen ndryshime pasi niveli i efijencës është i lartë por jo i pamundur. Ky kriter do të modifikohet.

Për sa i përket pikës 8 të pjesës së dytë të ankesës suaj lidhur me specifikimet teknike sqarojmë:

Për sa i përket kabullit të kërkuar nga ana jonë atij FG16OR16, që zëvendëson atë të normativës së vjetër FG7(0)R, karakteristikat e tij janë: Tension nominal 0.6/1kV, temperaturë pune -15 °C - +90 °C, i izoluar shtresa lart me gomë Etilenpropileni (rezistente ndaj rezeve ultravyjollcë) dhe brenda me guajn në PVC, për përdorim ambient i jashtëm, i brendshëm, nëntokë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë.

Për sa i përket tipit të kabullit FS18OR18 ai zëvendëson atë FROR me këto karakteristika: Tension nominal 0.3/0.5kVac, temperaturë pune -15 °C - +70 °C.

Për sa i përket kërkesave tona për kabull për instalime fikse në ambient të jashtëm dhe instalim në lagështi nën tokë, FS18OR18 nuk plotëson plotësisht këto kritere.

Për sa i përket peshës ajo do hiqet nga specifikimet.

Përlllogaritja e seksionit të kabullit është bërë në bazë të rënies (humbjes) së tensionit, pasi për sa i përket llogaritjes së fuqisë në llogarisim + 30% të asaj të instaluar në rast të Shtimit të fuqisë në të ardhmen. Nuk e shohim të arsyeshme vendosjen e fuqisë së instaluar pasi edhe në specifikimet e vendosura në kabull nga prodhuesi është vetëm sigla e llojit të kabullit, certifikimi që mund të jetë ai i normativës italiane CEI-UNEL si në rastin e kabullit të sugjeruar nga ana juaj, tension nominal dhe ai i izolimit.

Ky kriter do të modifikohet bazuar edhe në argumentimin e mësipërm.[...]

II.7. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 241/2021, datë 25.05.2021 ka vendosur:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me Nr. REF-94482-05-04-2021 me objekt “Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”, me fond limit 4,166,572 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 25.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.*
- 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
- 3. Kopje e këtij vendimi të dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag Utilities” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...] Referuar nenit 81 pika 4 dhe 5 e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se përdorimi nga të tretët i automjeteve përfshin dhënien me qira të tyre me ose pa drejtues mjeti dhe në asnjë rast nuk pranohet dhënia e automjeteve në huapërdorje, vlerësojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor për provimin e disponueshmërisë së automjeteve edhe me anë të kontratës së huapërdorjes është në kundërshtim me ligjin e posaçëm pasi Kodi Rrugor parashikon se përdorimi nga të tretët i automjeteve përfshin dhënien me qira të tyre pa drejtues mjeti dhe në asnjë rast dhënien e mjetit me huapërdorje. Në rastin konkret, vlerësojmë se për sa kohë që ka një rregullim të posaçëm (lex specialis) përjashton rregullimin e përgjithshëm (lex generalis) për rrjedhojë kërkesa për disponimin e automjeteve edhe me huapërdorje është një

kërkesë e pa mbështetur në ligj. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP 363/2016) [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, pika 3.6 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“6.Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose me qira 1 (një) kamion me vinç me kapacitet mbajtës nga 5 ton - 10 ton.

Për të vërtetuar këtë mjet duhet të paraqiten dokumentet si më poshtë:

- lejen e qarkullimit.*
- certifikatën e pronësisë.*
- siguracionin e mjetit.*
- kolaudimin.*
- certifikatë transporti.*
- fotografi të mjetit te paraqitur.*

Pranohet marrja me qira ose huapërdorje e mjeteve te mesiperme, me kusht qe kontrata e qiramarrjes ose huapërdorjes te jete bere para noterit, me afat vlefshmerie.”

III.1.2. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.3. Në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7 dhe 8, të nenit 81, “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: “[...]”

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.

2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
 - a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;
 - b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
 - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
 - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;
 - e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
 - f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

...

7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.
8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. [...]"

III.1.4. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (mjetin e transportit), në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës objekt prokurimi. Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin, se duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. Komisioni gjykon se, gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, krahas përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, autoritetet kontraktore duhet të kujdesen që kriteret e kualifikimit të jenë gjithashtu në përputhje të plotë me legjislacionin të posaçëm sektorial në fuqi. Pikat 4 dhe 5 të nenit 81 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, parashikojnë se përdorimi nga të tretët i automjeteve përfshin dhënien me qira të tyre me apo pa drejtues mjeti dhe në asnjë rast nuk lejohet dhënia e automjeteve në huapërdorje. Komisioni gjykon se pavarësisht se Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë parashikon edhe huapërdorjen si mënyrë posedimi dhe përdorimi të një sendi të luajtshëm, Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë e kufizon në mënyrë të posaçme mënyrën e posedimit dhe përdorimit të mjeteve të transportit rrugor, duke mos e përfshirë huapërdorjen si metodë të autorizuar për përdorimin e mjeteve nga të tretët. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese, si dhe të jenë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe sektorial në fuqi. Në këto kushte, Komisioni gjykon

përcaktimi i bërë nga ana e autoritetit kontraktor *“Pranohet marrja me qira ose huapërdorje e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qiramarrjes ose huapërdorjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie”*, nuk është parashikuar në përputhje me kërkesat ligjore si më sipër cituar, ndaj kriteri i mësipërm duhet të rihartohet në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit, të ngritura në ankesën e paraqitur *“3. Në shtojcën 9, “Specifikimet teknike”, parashikohet se: “..... me temperature ngjyre jo me pak se 6400K, rendimenti i se ciles te jete te pakten 88%.”*

Sa më sipër kërkojmë nga autoriteti kontraktor të na sqarohet se çfarë nënkuptoni me këtë, ndriçuesi duhet të jetë 6400K apo mund të ofertohej edhe një ndriçues 5632K (rezultat i cili del nga përpjesëtimi i temperaturës së kërkuar të përpjesëtuar me përqindjen e rendimentit të vendosur nga autoriteti kontraktor)?

9. Në shtojcën 9, *“Specifikimet teknike”* parashikohet se : *“Të gjitha materialet e tjera duhet të jenë të certifikuara dhe të testuara, gjithashtu duhet të mbajnë logon CE dhe të jenë të përshatshme me normativat elektrike të Republikës së Shqipërisë.*

*Sa më sipër kërkojmë nga autoriteti kontraktor nëse në lidhje me këtë pikë kërkohet që duhet të dorëzohen në momentin e ofertimit certifikata dhe raporte testimi përkatëse për të gjitha produktet apo nënkuptohet thjeshtë fakti që të gjitha mallrat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike të parashikuara, pa qenë e nevojshme dorëzimi i certifikatave dhe test raporteve përkatëse në momentin e ofertimit”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime mbi specifikimet teknike. Në rastin konkret, Komisioni gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se specifikimi teknik është në përputhje me legjilacionin në fuqi për prokurimin publik), por në thelb është një paqartësi mbi kërkesën e autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik në ankesë ka theksuar paqartësinë në përmbushjen e specifikimeve teknike. Gjithashtu, KPP-ja konstaton se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në përputhje me nenin 75 të LPP-së i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.**

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”, ka dhënë sqarime të mjaftueshme për operatorin ekonomik ankimues, lidhur me specifikimet teknike të ankimuara, për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Por, Komisioni sjellë në vëmendje të autoritetit kontraktor, se këto sqarime duhet të publikohen në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Mag Utilities” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin:

“1. Në specifikimet teknike të ndricuesve është kërkuar specifikisht që ndricuesit të kenë të paktën 155 qeliza ndricimi LED. Gjithashtu është kërkuar që teknologjia LED të jetë e një prej tipeve Led SMD 2835, 3014, 3020, 3030, 3528, 5050, 5630.

Në lidhje me sa më sipër sqarohet se, sasia e ndriçimit që nevojitet për të ndricuar një rrugë, shesh, fasade, etj, edhe sipas normave Europiane të cilave autoriteti kontraktor i referohet shpesh në këtë DST, përcaktohet në bazë të fluksit të dritës në lumens ose LUX dhe kjo nuk ka të bëjë me sasinë e qelizave apo llojin e teknologjisë LED të përdorur. Sa më sipër gjykojmë se e rëndësishme është që OE të ofertojë teknologji LED, e cila sjell uljen e konsumit dhe rritjen e efijencës.

Autoriteti kontraktor duke përcaktuar sasinë e qelizave dhe serinë e teknologjisë LED që duhet përdorur, në mënyrë të padrejtë dhe diskriminuese limitoni OE në disa furnitorë të caktuar duke i hequr mundësi që çdo OE të ketë mundësinë të ofertojë materialin më të mirë në treg për karakteristikat e kërkuara dhe me teknologji ndoshta edhe më të reja dhe me efijencë më të lartë sesa ato që kërkohen. Sa më sipër, kërkojmë që këto kritere të hiqen si kritere të padrejta, dhe diskriminuese që çojnë në një trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë duke sjellë si pasojë edhe uljen e konkurrencës dhe të efijencës së procedurës së prokurimit objekt ankimi.

4. Në shtojcën 9, “Specifikimet teknike”, kërkohen gjithashtu edhe certifikatat e cilësisë CE EMS.

Në dijeninë tonë CE EMS është certifikim i shërbimeve të urgjencës mjekësore (Emergency medical services-EMS) që përcaktojnë aftësinë e personelit të urgjencës. Punonjësit e EMS që zakonisht kërkojnë certifikim janë EMT dhe ndihmësmjekët dhe nuk ka asnjë lidhje me ndriçuesit e asnjë lloji.

Sa më sipër e vlerësojmë tërësisht të padrejtë, të panevojshëm dhe diskriminues kërkesën për disponimin e këtij certifikimi, dhe kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

5. Në përshkrimin e karakteristikave të ndriçuesit fillimisht kërkohet që temperatura e funksionimit të ndriçuesit të jetë -18 °C në +42 °C dhe më tej në dokument kërkoni që kjo temperaturë të jetë -28 °C - +42 °C,

Ju lutemi të saktësoni se kujt nga këto të dhëna duhet ti referohemi për të ofertuar produktet tona.

6. Në shtojcën 9, “Specifikimet teknike”, specifikimet e ndriçuesit përcaktohet që frekuenca e funksionimit duhet të jetë 50hz, ndërkohë që në automat e kërkoni që kjo frekuencë të jetë 50-60hz. Sa më sipër, kërkojmë modifikimin e këtij kriteri.

7. Në shtojcën 9, “Specifikimet teknike”, në zërat shtylla dhe krahë iu përcaktoni peshën e tyre. E vlerësojmë diskriminuese, të panevojshme përcaktimin e peshës së shtyllës ose krahëve kur autoriteti kontraktor ka vendosur edhe shumë kritere të tjera të cilat lidhen me fortësinë dhe rezistencën e shtyllës. Ky kriter kufizon mundësinë e OE për ofertime të tjera të shtyllave të përbëra nga një metal e teknologji më e mirë, ndaj kërkojmë që ky kriter të hiqet.

Gjithashtu në kërkesat e bëra për shtyllat Ju përcaktoni edhe nevojën e pajisjes së tyre me kapakë me çelës për mundësimin e lidhjes së ndriçuesit me rrjetin elektrik (gjë e cila është mëse e kuptueshme dhe normale), por gjithashtu kërkonte peshën e kapakut dhe certifikime të kapakut për IP dhe IK, certifikime të cilat nuk mund të jenë të kapakut më vete por janë të përfshira në certifikimin e shtyllës. Ndaj përsa mësipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri.

Gjithashtu, kërkojmë që në specifikimet teknike të përcaktohet së pari termi ekuivalent, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si edhe të përcaktohen të dhëna teknike minimale dhe jo parametra fikse, të cilat mund të jenë përjashtuese apo kufizuese, pasi parametrat fikse të çojnë detyrimisht drejt një produktit të vetëm.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 9, “Specifikime teknike”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

“Karakteristikat teknike të kërkuara:

Zëri nr. 1 – Ndrriçues LED 100W

Ndrriçuesi duhet të jetë me të paktën 155 qeliza ndriçimi LED dhe të ofrojë një rendiment të ndriçimit me të paktën 12000 lumen. Struktura duhet të jetë e përbërë prej alumini të derdhur dhe të ketë shkallë mbrojtjeje të paktën IP65. Teknologjia e ndërtimit të çipeve LED duhet të garantojë të paktën një kursim prej 80% të energjisë, të ketë një jetëgjatësi prej të paktën 28500 orë pune dhe të ofrohet me një garanci të paktën 5 vjeçare, prodhimi i se cilës te jete ne përputhje me standardet IEC 60598 dhe EN 61547. Transmetimi i dritës duhet të jetë uniformë, të ketë kënd shpërndarjeje jo më të vogël se 110° dhe me temperaturë ngjyre jo me pak se 6400K, rendimenti i së cilës të jetë të paktën 88%. Ndrriçuesi duhet të ketë një shkallë mbrojtjeje mekanike të paktën të gradës IK08 dhe duhet të jetë operativ në diapazonin e temperaturave nga -18°C në +42°C. Të jetë lehtësisht i montueshëm në shtyllat e ndriçimit dhe të ofrojë mundësi manovrimi sipas nevojave. Për ndriçuesin duhet të paraqiten certifikatat e cilësisë së prodhuesit, si dhe certifikatat e cilësisë CE (EMS dhe LVD). Trupi ndriçues duhet të jetë i certifikuar sipas normave evropiane dhe të përmbajë markën CE. Të jetë i lehtë në çmontim dhe montim në momentet që kërkohe të bëhet mirëmbajtje. Montimi të jetë i mundur në krahët e shtyllave tradicionale me diametër 48 mm dhe 60 mm.

Fuqia [W]: 100 W

Fluksi i ndriçimit [lm] : $\geq 12\ 000$ lm

Klasi i mbrojtjes [IPXX]: IP65

Tensioni i ushqimit [V]: 220 – 240 V

Frekuenca e funksionimit [Hz]: 50Hz

Teknologjia [tipi]: Led SMD 2835, 3014, 3020, 3030, 3528, 5050, 5630.

Materiali: metal

Ngjyra e trupit: gri e zënë

Temperatura e dritës [K]: 6400K

Jetëgjatësia mesatare [h]: $\geq 28\ 500$

Klasa e efikasitetit të energjisë: A++

Temperatura e funksionimit: -28°C ~ +42°C

Këndi i ndricimit: $\geq 110^\circ$

Zëri nr. 2 – Ndrives LED 50W

Ndrivesi duhet të jetë më të paktën 76 qeliza ndricimi LED dhe të ofrojë një rendiment të ndricimit me të paktën 5800 lumen. Struktura duhet të jetë e përbërë prej alumini të derdhur dhe të ketë shkallë mbrojtjeje të paktën IP65. Teknologjia e ndërtimit të çipeve LED duhet të garantojë të paktën një kursim prej 80% të energjisë, të ketë një jetëgjatësi prej të paktën 28500 orë pune dhe të ofrohet me një garanci të paktën 5 vjeçare, prodhimi i së cilës të jetë në përputhje me standardet IEC 60598 dhe EN 61547. Transmetimi i dritës duhet të jetë uniformë, të ketë kënd shpërndarjeje jo më të vogël se 110° dhe me temperaturë ngjyre jo më pak se 6400K, rendimenti i së cilës të jetë të paktën 88%. Ndrivesi duhet të ketë një shkallë mbrojtjeje mekanike të paktën të gradës IK08 dhe duhet të jetë operativ në diapazonin e temperaturave nga -18°C në $+42^\circ\text{C}$. Të jetë lehtësisht i montueshëm në shtyllat e ndricimit dhe të ofrojë mundësi manovrimi sipas nevojave. Për ndrivesin duhet të paraqiten certifikatat e cilësisë së prodhuesit, si dhe certifikatat e cilësisë CE (EMS dhe LVD). Trupi ndrives duhet të jetë i certifikuar sipas normave evropiane dhe të përmbajë markën CE. Të jetë i lehtë në çmontim dhe montim në momentet që kërkohet të bëhet mirëmbajtje. Montimi të jetë i mundur në krahët e shtyllave tradicionale me diametër 48mm dhe 60mm.

Fuqia [W]: 50 W

Fluksi i ndricimit [lm] : ≥ 5800 lm

Klasi i mbrojtjes [IPXX]: IP65

Tensioni i ushqimit [V]: 220 – 240 V

Frekuenca e funksionimit [Hz]: 50Hz

Teknologjia [tipi]: Led SMD 2835, 3014, 3020, 3030, 3528, 5050, 5630.

Materiali: metal

Ngjyra e trupit: gri e zënë

Temperatura e dritës [K]: 6400K

Jetëgjatësia mesatare [h]: $>28\ 500$

Klasa e efikasitetit të energjisë: A++

Temperatura e funksionimit: $-18^\circ\text{C} \sim +42^\circ\text{C}$

Këndi i ndricimit: $\geq 110^\circ$

Zëri nr. 3 – Shtylla metalike 7m

Gjatesia e shtylles duhet të jete 6.5 - 7 m. Shtylla duhet të jete e galvanizuar në të nxehtë. Trashësia e materialit nuk duhet të jete më e vogël se 3.8 mm. Diametri i bazës së poshtme nuk duhet të jete më i madh se 157 mm ndërsa diametri i bazës së sipërme nuk duhet të jete më i madh se 63mm. Peshë e shtylles duhet të jete midis 78-84kg. Materiali i shtylles duhet të jete çelik i tipit S235 JRH sipas standardit EN 10219 ose ekuivalent. Rezistenca në tërheqje duhet të jete ndërmjet 340 – 510 N/mm² dhe zgjatja që mund të pesoje materiali të jete jo më e madhe se 22%. Shtylla duhet të jete e lyer me bojë hidrostatike me pluhur sipas kodit RAL 9007. Gjithashtu, shtylla duhet të jete e pajisur me një hapësirë të prerë me permasa jo më të vogla se 183x43 mm. Kjo hapësirë nevojitet për lidhjen e ndrivesit me rrjetin elektrik. Kapaku duhet të jete i pajisur me çelës, duhet të kete perberje alumini dhe një peshe jo më të madhe se 300gr. Kapaku duhet të kete një shkallë mbrojtjeje IP 54 në përputhje me standardin CEI 60529 dhe një

rezistence ndaj goditjes IK 08 ne perputhje me standardin EN 50102. Per te vertetuar cilesine dhe perputhshmerine e mallit operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate cilesie te prodhuesit dhe certifikaten e konformitetit.

Zëri nr. 4 – Shtylle dekorative e kompletuar

Gjatesia e shtylles duhet te jete jo me e madhe se 2.2m. Diametri i shtylles duhet te jete jo me i vogel se 55mm. Pesha e shtylles se bashku me krahet duhet te jete jo me e madhe se 14kg. Materiali i shtylles duhet te jete celik i tipit S235 JRH sipas standardit EN 10219 ose ekuivalent. Rezistenca ne terheqje duhet te jete ndermjet 340 – 510 N/mm² dhe zgjatja qe mund te pesoje materiali te jete jo me e madhe se 22%. Shtylla duhet te jete e lyer me boje hidrostatike me pluhur sipas kodit RAL 9007. Krahet dekorative duhet te te kene nje largesi nga qendra jo me te madhe se 260mm, nje lartesi jo me te vogel se 240mm dhe nje diameter 58 – 72mm. Gjithashtu, shtylla duhet te jete e pajisur me nje hapësire te prere me permasa jo me te vogla se 130x35 mm. Kjo hapësire nevojitet per lidhjen e ndricuesit me rrjetin elektrik. Kapaku duhet te jete i pajisur me celes, duhet te kete perberje alumini dhe nje peshe jo me te madhe se 190gr. Kapaku duhet te kete nje shkalle mbrojtjeje IP 54 ne perputhje me standardin CEI 60529 dhe nje rezistence ndaj goditjes IK 08 ne perputhje me standardin EN 50102. Per te vertetuar cilesine dhe perputhshmerine e mallit operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate cilesie te prodhuesit dhe certifikaten e konformitetit.



(shtylle dekorative)

Zëri nr. 5 – Shtylle metalike per ndricim 4.5m

Gjatesia e shtylles duhet e jete 4.2-4.7 m. Shtylla duhet te jete e galvanizuar ne te nxehte. Trashesia e materialit nuk duhet te jete me e vogel se 2.75mm. Diametri i bazes se poshtme nuk duhet te jete me i madh se 160 mm ndersa diametri i bazes se sipërme nuk duhet te jete me i madh se 62mm. Pesha e shtylles duhet te jete midis 26-32kg. Materiali i shtylles duhet te jete celik i tipit S235 JR sipas standardit EN 10025 ose ekuivalent. Rezistenca ne terheqje duhet te jete ndermjet 340 – 510 N/mm² dhe zgjatja qe mund te pesoje materiali te jete jo me e madhe se 22%. Shtylla duhet te jete e lyer me boje hidrostatike me pluhur sipas kodit RAL 9007. Gjithashtu, shtylla duhet te jete e pajisur me nje hapësire te prere me permasa jo me te vogla se 130x35 mm. Kjo hapësire nevojitet per lidhjen e ndricuesit me rrjetin elektrik. Kapaku duhet te jete i pajisur me celes, duhet te kete perberje alumini dhe nje peshe jo me te madhe se 190gr. Kapaku duhet te kete nje shkalle mbrojtjeje IP 54 ne perputhje me standardin CEI 60529 dhe nje rezistence ndaj goditjes IK 08 ne perputhje me standardin EN 50102. Per te vertetuar cilesine dhe perputhshmerine e mallit operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate cilesie te prodhuesit dhe certifikaten e konformitetit.

Zëri nr. 6 – Krahe me dy qafore per shtylle b/a

Krahu duhet te jete i perbere prej celiku te galvanizuar ne te nxehte sipas standardeve Europiane. Gjatesia e krahut nuk duhet te jete me e madhe se 1.7 m dhe lartesia e tij nuk duhet te jete me e madhe se 1.65 m. Pesha e krahut se bashku me qaforet mbajtese duhet te jete me e madhe se 16 kg. Qaforet lidhese duhet te kene nje mekanizem shtrengimi me vidhosje, diametri i krahut nuk duhet te jete me i vogel se 57 mm. Per te vertetuar cilesine dhe perputhshmerine e mallit operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate cilesie te prodhuesit dhe certifikaten e konformitetit.



(krah per shtylle b/a)

Zëri nr. 7 - Krah 1500mm

Krahu duhet te kete permasa 1.5x1.5m. Diametri i krahut duhet te jete midis 57 – 64mm. Rrezja e krahut nuk duhet te jete me e vogel se 0.8 m. Pesha e krahut duhet te jete jo me e madhe se 13 kg. Krahet duhet te jene te lyer me boje hidrostatike me pluhur sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. Per te vertetuar cilesine dhe perputhshmerine e mallit operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate cilesie te prodhuesit dhe certifikaten e konformitetit.

Zëri nr. 11 – Automat 1P 10A

Automati duhet te jete i prodhuar sipas standardeve IEC 60947 dhe EN 60898 ose ekuivalent. Te jete i tipit termo-magnetik dhe operativ ne tension 240 V. Fuqia ne çkyçje e automatit duhet te jete te pakten 8.8 kA, frekuenca 50-60Hz dhe kurba e nderhyrjes C . Te ofroje qendrueshmeri elektrike te pakten per 9000 cikle operative, te kete klase mbrojtjeje te pakten IP20 dhe rezistent deri ne temperatura +68°C. Per automatit duhet te paraqiten certifikatat e cilesise se prodhuesit, si dhe certifikatat e cilesise CE.

Zëri nr. 19 – Kabllo bakri 4x4

Kablli duhet te jete i prodhuar ne perputhje me standardet europiane EN 6050575, IEC 60502 ose ekuivalente. Kablli duhet te kete veti te shkelqyera si elektrike, ashtu dhe mekanike dhe te jete i pershtatshem per operime deri ne 1kV. Duhet te kete izolim cilesor me material PVC dhe veshje te dyfishte me gome. Percjellesi i kabullit te kete diameter jo me te vogel se 13.3 mm dhe me peshe specifike jo me te vogel se 380 g/m. Percjellesi te kete rezistence te pakten 4.28 ohm/km. Te jete rezistent ndaj zjarrit dhe ne perputhje me standardin EN 60332. Kablli duhet te jete i pershtatshem per instalime te jashtme dhe te permbaj siglen FG7(O)R ose ate te normatives se re FG16OR16. Te paraqiten certifikatat CE te produktit dhe ato te cilesise se prodhuesit per te vertetuar perputhshmerine me standardet e kerkuara.

Zëri nr. 20 – Kabllo bakri 4x6

Kablli duhet te jete i prodhuar ne perputhje me standardet europiane EN 6050575, IEC 60502 ose ekuivalente. Kablli duhet te kete veti te shkelqyera si elektrike, ashtu dhe mekanike dhe te

jete i pershtatshem per operime deri ne 1kV. Duhet te kete izolim cilesor me material PVC dhe veshje gome. Percjellesi i kabllit te kete diameter jo me te vogel se 14.8 mm dhe me peshe specifike jo me te vogel se 470 g/m. Percjellesi te kete rezistence te pakten 2.98 ohm/km. Te jete rezistent ndaj zjarrit dhe ne perputhje me standardin EN 60332. Fuqia minimale e rezistences ne djegie te mos jete me e ulet se 39.7A. Kablli duhet te jete i pershtatshem per instalime te jashtme dhe te permbajë siglen FG7(O)R ose ate te normatives se re FG16OR16. Te paraqiten certifikatat CE te produktit dhe ato te cilesise se prodhuesit per te vertetuar perputhshmerine me standardet e kerkuara.

Zëri nr. 21 – Kabllo bakri 3x4

Kabulli duhet te jete i prodhuar ne perputhje me standardet europiane EN 6050575, IEC 60502 ose ekuivalente. Kablli duhet te kete veti te shkelqyera si elektrike, ashtu dhe mekanike dhe te jete i pershtatshem per operime deri ne 1kV. Duhet te kete izolim cilesor me material PVC dhe veshje te dyfishte. Percjellesi i kabllit te kete diameter jo me te vogel se 12.6mm dhe me peshe specifike jo me te vogel se 317 g/m. Percjellesi te kete rezistence te pakten 4.47 ohm/km. Te jete rezistent ndaj zjarrit dhe ne perputhje me standardin EN 60332. Fuqia minimale e rezistences ne djegie te mos jete me e ulet se 31.8A. Kablli duhet te jete i pershtatshem per instalime te jashtme dhe te permbaje siglen FG7(O)R ose ate te normatives se re FG16OR16. Te paraqiten certifikatat CE te produktit dhe ato te cilesise se prodhuesit per te vertetuar perputhshmerine me standardet e kerkuara.

Zëri nr. 22 – Kabllo bakri 3x2.5

Kablli duhet te jete i prodhuar ne perputhje me standardet europiane EN 6050575, IEC 60502 ose ekuivalente. Kablli duhet te kete veti te shkelqyera si elektrike, ashtu dhe mekanike dhe te jete i pershtatshem per operime deri ne 1kV. Duhet te kete izolim cilesor me material PVC dhe veshje te dyfishte. Percjellesi i kabllit te kete diameter jo me te vogel se 10.7 mm dhe me peshe specifike jo me te vogel se 210 g/m. Percjellesi te kete rezistence te pakten 7.28 ohm/km. Te jete rezistent ndaj zjarrit dhe ne perputhje me standardin EN 60332. Fuqia minimale e rezistences ne djegie te mos jete me e ulet se 22.8A. Te paraqiten certifikatat CE te produktit dhe ato te cilesise se prodhuesit per te vertetuar perputhshmerine me standardet e kerkuara.

Zëri nr. 23 – Kabllo bakri 3x1.5

Kablli duhet te jete i prodhuar ne perputhje me standardet europiane EN 6050575, IEC 60502 ose ekuivalente. Kablli duhet te kete veti te shkelqyera si elektrike, ashtu dhe mekanike dhe te jete i pershtatshem per operime deri ne 1kV. Duhet te kete izolim cilesor me material PVC dhe veshje te dyfishte PVC. Percjellesi i kabllit te kete diameter jo me te vogel se 10.8 mm dhe me peshe specifike jo me te vogel se 176 g/m. Percjellesi te kete rezistence te pakten 11.85 ohm/km. Te jete rezistent ndaj zjarrit dhe ne perputhje me standardin EN 60332. Fuqia minimale e rezistences ne djegie te mos jete me e ulet se 17.6A. Te paraqiten certifikatat CE te produktit dhe ato te cilesise se prodhuesit per te vertetuar perputhshmerine me standardet e kerkuara.

Të gjitha materialet e tjera duhet të jenë të certifikuara dhe të testuara, gjithashtu duhet të mbajnë logon CE dhe të jene te pershtatshme me normativat elektrike të Republikës së Shqipërisë.”

III.3.2. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera

teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për

prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohet për një punë, shërbim ose furnizim”* Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe, kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”**

III.3.4. KPP gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Sa më sipër, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknike kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë dhe me diapazon të gjerë duke përdorur një minimum dhe një maksimum të parametrave në mënyrë që të rritet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomik me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të provohet se mallrat objekt prokurimi, përmbushin kushtet funksionale dhe estetike, si dhe standardet e cilësisë dhe konformitetit.

III.3.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi përcaktimin nga ana e autoritetit kontraktor të teknologjisë (tipit) të ndriçuesve, numrit të qelizave, apo peshave të shtyllave, nga shqyrtimi i specifikimeve teknike, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në mënyrë tepër të detajuar teknologjitë dhe disa përmasa të mallrave objekt prokurimi të cilat nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me funksionalitetin, estetikën dhe qëllimin e blerjes të këtyre mallrave, duke shkaktuar kufizime të konkurrencës tërësisht të panevojshme. Komisioni gjykon se specifikime teknike të rëndësishme që lidhen drejtpërdrejtë me funksionalitetin e ndriçuesve janë ngjyra e ndriçimit, fluksi i ndriçimit, konsumi eficient i energjisë, karakteristikat estetike, si dhe jetëgjatësia e tyre ku përfshihen mbrojtja nga agjentët e jashtëm dhe goditjet mekanike. Funksionalitet e kërkuara si ngjyra dhe fluksi i ndriçimit apo konsumi eficient i energjisë mund të arrihen më së miri me teknologji të ndryshme dhe numër qelizash të ndryshme. E njëjta gjë vlen edhe për anën estetike të ndriçuesve, ku pesha nuk ndikon aspak në pamjen apo cilësinë e tyre.

KPP gjykon se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, por pa përcaktuar specifikime teknike fikse, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, të cilat ulin konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, ndaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike duke mos e përcaktuar teknologjinë e ndriçuesve, numrin e qelizave të ndriçimit, si dhe peshën e produkteve që do të prokurohen.

III.3.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi kërkesën e certifikatave të cilësisë CE EMS, nga shqyrtimi i specifikimeve teknike, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se për zërin nr.1 – Ndriçues LED 100W dhe zërin nr.2 – Ndriçues LED 50W, duhen paraqitur certifikatat e cilësisë CE (EMS dhe LVD). Nga verifikimet e kryera, Komisioni konstatoi se certifikimi i cilësisë EMS është tërësisht i paqartë, pasi rezultojnë disa certifikime me akronimin EMS, të cilat nuk lidhen aspak me certifikimin e cilësisë për produktet objekt prokurimi. Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të kishte përcaktuar më qartë variantin e certifikatës të cilësisë, duke kërkuar titullin e plotë të certifikatës që kërkohet, në mënyrë që të identifikohen e lehtësisht dhe që të krijohet panoramë e qartë mbi kapacitetet e kërkuara, të mos krijohet konfuzion si tek operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, ashtu edhe tek anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave gjatë procesit të shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave, duke mos krijuar hapësirë për vlerësim subjektiv. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike për zërat nr.1 dhe nr.2, duke e përcaktuar në mënyrë të qartë variantin e certifikatës së cilësisë të kërkuar.

III.3.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi mospërputhjen e specifikimeve teknike lidhur me temperaturën e funksionimit të ndriçuesit, Komisioni konstaton se në pjesën narrative të specifikimeve teknike për zërin nr.1 – Ndriçues LED 100W, përcaktohet se “[...]duhet të jetë operativ në diapazonin e temperaturave nga -18°C në $+42^{\circ}\text{C}$ [...]”, ndërsa në vijim, për të njëjtin produkt përcaktohet “*Temperatura e funksionimit: $-28^{\circ}\text{C} \sim +42^{\circ}\text{C}$ ”, duke shkaktuar paqartësi te operatorët ekonomik të interesuar, për hartimin e ofertave. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim*

me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka lënë vend për konfuzion, pasi ka mospërputhje të specifikimeve teknike për të njëjtin tregues, për të njëjtin produkt, duke përcaktuar diapazone të ndryshme temperature funksionimi për ndriçuesin LED 100W. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të unifikojë kërkesat mbi diapazonin e temperaturës së funksionimit për ndriçuesin LED 100W, në mënyrë që të krijohet panoramë e qartë mbi furnizimet që do të kryhen, si dhe të mos krijohet konfuzion tek operatorët ekonomikë të interesuar për të hartuar ofertat e tyre teknike dhe ekonomike. Vlen të theksohet, se dokumentet e tenderit, nga autoriteti kontraktor, duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.3.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi përcaktimin nga ana e autoritetit kontraktor “*[...]Kapaku duhet te kete nje shkalle mbrojtjeje IP 54 ne perputhje me standardin CEI 60529 dhe nje rezistence ndaj goditjes IK 08[...]*”, Komisioni vëren se vlerësimet IP përcaktohen në standardet ndërkombëtare EN 60529 (British BS EN 60529: 1992, European IEC 60509: 1989) ose ekuivalente të tyre. Ato përdoren për të përcaktuar nivelet e efektivitetit të mbylljes së pajisjeve elektrike kundër ndërhyrjes nga trupat e huaj (mjetet, papastërtitë etj.) dhe lagështisë. Ndërsa vlerësimi IK është një kod ndërkombëtar që mat shkallën e mbrojtjes nga goditjet mekanike, si dhe sasinë e goditjes që mund të marrë një pajisje e veçantë. Në thelb është një masë e qëndrueshmërisë së pajisjeve ndaj goditjeve të ndryshme. Në rastin konkretë, referuar objektit të prokurimit, të cilat janë shtylla ndriçimi që janë totalisht të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike dhe goditjeve të mundshme mekanike, Komisioni gjykon se kërkesa që këto shtylla ndriçimi duhet të jenë të certifikuara për mbrojtjen nga depërtimi i trupave të huaj dhe lagështisë, si dhe mbrojtjen nga goditjet është një kërkesë e nevojshme dhe në përputhje me volumin dhe objektin e kontratës që kërkohet. Gjithsesi, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë kufizime duke përcaktuar vetëm certifikimeve për pjesë të veçanta të shtyllave të ndriçimit, pasi e rëndësishme është që të vërtetohet qëndrueshmëria e këtyre produkteve ndaj kushteve atmosferike dhe goditjeve të mundshme mekanike, pavarësisht nëse certifikimet janë në tërësi për të gjithë produktin, apo për elementët e veçantë të tij. Në këto kushte, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimin teknik të mësipërm për të mos krijuar kufizime të panevojshme.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.3.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi përcaktimin nga ana e autoritetit kontraktor se frekuenca e funksionimit duhet të jetë 50hz, ndërkohë që në automat kërkohet që kjo frekuencë të jetë 50-60hz, Komisioni konstaton se ankimuesi nuk e ka bërë të qartë pretendimin e tij se përse kërkon modifikimin e këtyre specifikimeve teknike, si dhe për më tepër kë nga këto specifikime teknike konsideron që nuk është përcaktuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi për prokurimin publik dhe që i konsideron si kufizues. Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ankimues ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij, si dhe ta argumentojë atë.

I njëjti qëndrim vlen edhe për pretendimin “Gjithashtu, kërkojmë që në specifikimet teknike të përcaktohet së pari termi ekuivalent, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si edhe të përcaktohen të dhëna teknike minimale dhe jo parametra fikse, të cilat mund të jenë përjashtuese apo kufizuese, pasi parametrat fikse të çojnë detyrimisht drejt një produktit të vetëm.”, pasi ankimuesi duhet të kishte identifikuar se cilat nga specifikimet teknike i konsideron si parametra fikse, të cilat të drejtojnë në një produkt të vetëm, si dhe duhet të kishte identifikuar se ku duhet të përcaktohet termi ekuivalent në këto specifikime teknike.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mag Utilities” SHPK për procedurën e prokurimit Nr. REF-94482-05-04-2021 me objekt “*Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore*”, me fond limit 4,166,572 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 25.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Mag Utilities” SHPK
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri